



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

Tabela paraprake e vlerësimit të fakteve/vlerësimit nga monitorimi		Datë: 21.11.2018	Numri i seancës për këtë çështje: 2 (dy). 1 seancë dëgjimore + 1 seancë dhënie vendimi
Ky monitorim u realizua në kuadër të projektit nr.2 "Për të rritur transparencën, gjithëpërfshirjen dhe përgjegjshmërinë në procesin e Vettingut"- projekt i mbështetur financiarisht nga Fondacioni për Shoqërinë e Hapur Shqipëri (OSFA) dhe zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH).			
A. Informacioni bazë			
Institucioni dhe tema:	Institucioni: Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (këtu e më poshtë KPK). Objekti: Procesi i Vettingut të subjektit të rivlerësimit Znj. Fjona Papajorgji.		
Emri i subjektit të rivlerësimit	Znj. Fjona Papajorgji.		
Pozicioni i punës/ qyteti nëse nuk është Tirana	Këshilltare ligjore në Gjykatën Kushtetuese.		
A u shty seanca dhe a ishte e arsyeshme kjo shtyrje?	Seanca u zhvillua e plotë, në intervalin kohor 10:00-10:30 (30 minuta). Trupa gjyqësore e KPK u tërhoq për të marrë vendimin, duke shtyrë seancën për 4 ditë (dt. 26 nëntor).		
A u shpall vendimi apo jo (Ju lutem paraqisni arsyet në mënyrë të përmblodhur)	Shpallja e vendimit është shtyrë për dt. 26 nëntor, ora 09:15.		
B. Aktorët që marrin pjesë në proces/seanca			
Trupa gjyqësore (emrat)	Brunilda Bekteshi - Kryetare e trupit gjyqësor; Roland Ilia - Relator i çështjes; Olsi Komici - anëtar i trupit gjyqësor; asistohen nga sekretarja gjyqësore- Anisa Duka. Të pranishëm pa shkëputje gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.		
Monitoruesit ndërkombëtarë (emrat)	Në cilësinë e vëzhguesit ndërkombëtar paraqitet, z. Theo Jacobs. I pranishëm pa shkëputje gjatë zhvillimit të seancës.		
Mbrojtje me avokat apo mbrojtje personalisht (specifikoni)	Mbrojtja u realizua personalisht.		
Monitoruesi/ja i/e KSHH:	Albana Misja		
Anëtarë të tjerë të publikut të pranishëm?	Numri i anëtarëve nga publiku konstatohet të jetë rreth 20 persona, pavarësisht masave të sigurisë, me akses të plotë në hyrjen e godinës dhe pjesëmarrje fizike në seancën dëgjimore. Akomodimi u krye në formë të rregullt nga stafi menaxhues i KPK.		
Media e pranishme:	Mediat lokale ishin të pranishme, me përafërsisht 5 përfaqësues, me akses të plotë në hyrjen e godinës. Megjithatë pjesëmarrja e tyre u lejua vetëm në fazën përgatitore të seancës dëgjimore, pas së cilës largohen nga salla së bashku me mjetet e regjistrimit, referuar nenit 3 të Rregullores "Për marrëdhëniet me median".		
C. A vendosi institucioni i vettingut ta bëjë vettingun për të tre kriteret apo bazuar vetëm në një apo dy prej tyre?	Po/Jo	Nëse po, si u justifikua ai?	Nëse po, si ka reaguar subjekti ndaj kësaj ?
	Po	Trupa gjyqësore vendosi të përfundojë hetimin administrativ kryesisht dhe të paraqesë rezultatet e tij për të tre kriteret e rivlerësimit: vlerësimit të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale dhe etike.	

D. Përbajtja e çështjes (Vlerësimi i kritereve)	Argumenti	kush e ka dhënë argumentin	A u diskutua? Prova? A u kalua barra e provës?	
D1. Pasuria	<p>Referuar të dhënave në Raportin Vlerësues të ILDKPKI dorëzuar pranë Komisionit, në lidhje me subjektin e rivlerësimit konstatohet se: Deklarimi nuk është i saktë dhe në përputhje me ligjin, dhe subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues, ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; ka mos deklaramë të pasurisë; nuk ka kryer deklarim të rremë; nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit. Ky konstatim mbështetet në:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1- Subjekti nuk ka deklaruar burimin e shumës 31,950 Euro dhe nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues, mbi burimin e kursimeve familjare, të cilët kanë shërbyer për blerjen e apartamentit (2004). 2- Nuk ka depozituar dokument justifikues për të atin, mbi burimin e shumës 7000 Euro, që kanë shërbyer për blerje automjeti. 3- Nuk ka depozituar dokument justifikues për blerje automjeti (Ford), si dhe Drejtoria e Transportit Rrugor nuk e konfirmon regjistruar këtë automjet. 4- Ka paraqitur dokument justifikues në lidhje me bursën e përfutur që ka shërbyer për krijimin e një depozite bankare në Raiffeisen bank, por nuk ka paraqitur dokument justifikues lidhur me shpenzimet e studimeve, për të mundësuar llogaritjen se sa ka qenë mundësia e subjektit për të kursyer nga kjo bursë. 5- Automjet, shitur më 2013, nuk rezultoi të jetë deklaruar nga bashkëshorti i subjektit, dhe nuk është paraqitur kontrata e blerjes së këtij automjeti. Në deklaratën Vetting të dorëzuar, rezultojnë se subjekti dhe bashkëshorti i saj kanë deklaruar këto pasuri: <ul style="list-style-type: none"> 1- Apartament banimi, Tiranë, në vlerën 31, 950 Euro, pjesë takuese 100%. Burim krijimi: kursimet familjare, bursa gjatë studimeve në Itali, të ardhura nga puna. Përfutur me K. sipërmarrje 2004. 2- Auto veturë, Seat, 10,620 Euro, bashkëpronësi me të atin (pjesa takuese 35%), përfutur me k. qiraje financiare. Burim krijimi: shuma 7000 eur, nga kurseme familjare paguar cash nga i ati dhe shumën e mbetur paguar nga shuma e përfutur me k.qera financiare likuiduar nga paga e subjektit të rivlerësimit. 3- Auto veturë, Ford, blerë në Itali, 1500 Euro, nuk rezultoi të cdoganuar. 4- Depozite bankare pranë Raiffeisen Bank, vlera rreth 6, 580,000 leke. Burim krijimi: bursa e përfutur për studimet e realizuara në Itali (përfutur nga BE, rreth 41, 000 eur-35,000 euro neto). 5- likuiditete të tjera: gjendje llogarie për pagat nga gj. kushtetuese, vlera 73, 323 Lek; llogari bankare nga paga në universitetin Zonja e Këshillit të Mirë, 985 Euro; llogari bankare në emër të djalit, 445, 904 Lek. 6- Deklarimi i llogarisë rrjedhëse të pagës së bashkëshortit, rreth 290, 000 Lekë, konfirmohet me gjendjen e deklaruar në deklaratën vetting. 7- Automjet (Volksëagen), shitur për 1000 eur, nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit. 	Të dhëna nga raportet e ILDKPKI	<p>Provat e administruara nga Komisioni lidhur me Vlerësimin e pasurisë: Raporti i ILDKPKI, të dhëna të tjera (deklarata) nga subjekti i rivlerësimit, informacione shkresore marrë nga institucionet publike, dokumente të tjerë të dosjes. Subjekti i është kaluar barra e provës (referuar N. 52, ligjit 84/2016) për të paraqitur prova për pasurinë nr.1 (apartament, Tiranë), burimin e shumës së paguar, dhe dokumentacionin justifikues për të ardhurat që kanë shërbyer për blerjen. I është kërkuar të japë shpjegime në lidhje me pasurinë nr. 4 (depozite bankare, krijuar nga Bursa e studimit në Itali), dhe paraqitjen e dokumentacionit në gjuhë të huaj (noterizuar dhe me vulë apostile) për këtë pasuri.</p>	
	<p>Komisioni kreu hetim mbi vërtetësinë e deklaramëve të kryera nga subjekti i rivlerësimit, dhe burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje, KPK konstaton: 1- në lidhje me pasurinë (automjet Seat), konfirmohet, lidhja e k. së qerasë financiare dhe pagesa cash në shumën prej 7000 eur, nga i ati. Subjekti ka paraqitur dokumentacion justifikues lidhur me burimin e kësaj shume, si edhe pagesat e bëra në favor të shoqërisë leasing. Komisioni konfirmon: se subjekti disponon burime të ligjshme për këto pagesa. 2-Lidhur me pasurinë (llogaritë rrjedhëse bankare), komisioni deklaroi se nuk ka dyshime lidhur me burimin e ligjshëm të tyre. 3- Në lidhje me pasurinë nr. 7, konstatohet se martesja e subjektit rezultoi të jetë lidhur në 2013, përpara shitjes së automjetit. Komisioni vlerëson se të ardhurat e përfutura nga shitja e tij, duhet të deklaroheshin nga personi i lidhur (bashkëshorti), në deklaratën e vitit 2013.</p>	Relatori		
	nuk ka	Mbrojtja		
	<p>Subjekti i rivlerësimit prapëson: në lidhje me pasurinë autoveturë Ford, se është blerë me kursimet e saj, për posedim nuk disponon dokumentacion justifikues, për arsye se automjeti për disa vite nuk ndodhet në gjendje funksionale. Gjithashtu kërkon kohë për të mundësuar pajisjen e dokumenteve me vulë apostile, sipas kërkesave të Komisionit.</p>	Subjekti i rivlerësimit		
		Ankesa nga publiku		
		Përfaqësuesi i ONM		
	D2. Figura /Kontaktet me krimin e organizuar	Të dhënat nga raporti i DSIK, në përputhje me N.39 të ligjit 84/2016 „konstatojnë vlerësimin: "I Përshtatshëm" për vazhdimin e zhvillimit të detyrës	Të dhëna nga raportet e DSIK	Raporti Vlerësues i Drejtorisë së Sigurisë dhe Informacionit të Klasifikuar
Relatori i çështjes nuk referon qëndrimin e mbajtur nga Komisioni lidhur me këtë pikë		Relatori		
Subjekti i rivlerësimit konfirmon marrjen dijeni mbi dosjen dhe dokumentet provues. Aprovon vendimarrjen e DSIK.		Mbrojtja		
		Subjekti i rivlerësimit		
		Ankesa nga publiku		
D3. Vlerësimi i aftësive profesionale dhe etikës	Të dhënat marrë nga Inspektoriati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë: ka treguar se subjekti i rivlerësimit ka cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë dhe është eficient në masë të pranueshme.	Të dhëna nga Inspektoriati i KLD	<p>Provat e administruara në seance dëgjimore: në përputhje me N. 42, pika 2, i ligjit 84/2016, këshilltarët ligjor që nuk janë magistrat vlerësohen mbi Relacionet dhe punimet ligjore si dhe rezultatet e testimit të Shkollës së Magjistraturës (rendituri në subjektet që kanë arritur rezultat mbi 60 % të aftësive profesionale); Raporti i rivlerësimit të aftësive profesionale të Inspektoriatit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë; Formentave ligjorë të përgjdhura nga vetë subjekti, dhe analiza e 5 dosjeve gjyqësore të përgjdhura në formë rastësore.</p>	
	Relatori i çështjes nuk referon qëndrimin e mbajtur nga komisioni lidhur me këtë pikë	Relatori		
	nuk ka	Mbrojtja		
	Subjekti i rivlerësimit konfirmon marrjen dijeni mbi dosjen dhe dokumentet provues. Miraton deklaramet e KPK mbi përfundimet e hetimit administrativ lidhur me këtë pikë	Subjekti i rivlerësimit		
	nuk ka	Ankesa nga publiku		
Drejton pyetjen: Çfarë roli duhet të luaj Gjykata Kushtetuese në një shtet demokratik, në lidhje me autoritetet e tjera institucionale (meqë subjekti ka një eksperiencë më tepër se 7 vjeçare pranë këtij institucioni)?	Përfaqësuesi i ONM			
E. Konkluzione dhe komente të monitoruesit të KSHH (Vlerësimi paraprak i monitoruesit të KSHH për aspektet e vettingut dhe përfaqësuesit të OMN, si e vlerësoni hetimin administrativ, të drejtat e mbrojtjes së subjektit, barazia e mjeteve ligjore, parimi i kontradiktoritetit, koha e arsyeshme, e drejta për të paraqitur prova dhe e drejta për tu dëgjuar, etj.)	<p>Aksesi i pjesëmarrjes, nga publiku, shoqëria civile, institucionet e tjera të interesuara dhe mediat lokale është respektuar. Në ndryshim nga seancat e mëparshme, kryesuesja e trupës gjyqësore, për herë të parë refero bazën ligjore të rregullores "për marrëdhëniet me median", dhe specifikoj që gazetarët lejohen të jenë të prishëm, por mjetet e regjistrimit të largohen nga sala. Një përmirësim në terminologjinë e diktuar në seancat e mëparshme, ku urdhërohen të lënë sallën edhe gazetarët duke çnuar aksesin në seancë dëgjimore e cila zhvillohet me dyer të hapura. Etika e sjelljes së trupit gjyqësor është e rregullt dhe të folurit të kuptueshëm. Deklarohen nga relatori i çështjes dhe konfirmohen nga subjekti respektimi i të drejtave procedurale si: është njoftuar për procedurën e fillimit të rivlerësimit dhe përbërjen e trupës gjyqësore, për të cilët nuk ka pasur deklarim për konflikt interesi. është njohur me dokumentet e dosjes dhe të drejtat e saj në përputhje me K.Pr. A. I janë dhënë 17 ditë kohë për tu njohur me dosjen, dhe për të disponuar kopje të saj, si dhe iu bënë të ditura rezultatet e hetimit administrativ më 2 nëntor. Më 19 nëntor subjekti paraqiti qëndrimin e saj me shkrim. I rezervohet e drejta përfaqësuesit të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, dhe trupit gjyqësor të drejtojnë pyetje, dhe iu dha mundësia e falës në seancë dëgjimore subjektit të rivlerësimit. Kohëzgjatja e seancës dëgjimore është e arsyeshme (30 minuta). Trupi gjyqësor tërhoq për shpalljen e dispozitivit të vendimit, duke shtyrë dhënien e vendimit me 5 ditë (më dt. 26 Nëntor). Sa më sipër, seanca dëgjimore e subjektit të rivlerësimit Znj. Fjona Papajorgji, plotëson kriteret që referon ligji nr. 84/2016, Kodi i Procedurës Administrative (Nenet 45-47) dhe Aneksi shtojcë I Kushtetutës, referuar të drejtave procedurale dhe respektimit të elementeve përbërës të procesit të rregullit ligjor, mbrojtjes efektive, aksesit në gjykim, kohëzgjatjes së arsyeshme të seancës.</p>			